



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 134/13
Prishtinë, më 27.11.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Duda Balje, Sevdije Lama.

Munguan: Sali Asllanaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Hykmete Bajrami dhe Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli, Imba Rudaku (praktikante) dhe Arbëreshë Kosumi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Agim Sheqiri nga OSHP, Besim Beqaj-Ministër i Financave, Agim Krasniqi-Drejtor i Buxhetit, Blerand Kadrijaj nga Ministria e Financave, Ekrem Hoxha, Fatmir Gërvalla dhe Ilir Imeri nga-ARKEP, si dhe Haradin Gërvalla, Midin Bojaxhiu, Bush Jonuzi nga KPMM.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

R e n d i i d i t ë s:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 20.11.2013;**
3. **Miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje me amendamentet e Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja theksoj edhe pse raporti për mbikëqyrjen e Ligjit të Prokurimit Publik është radhitur për shqyrtim, duke vlerësuar vërejtjet që janë bërë me shkrim nga Znj. Bajrami, mendoj që duhet të shtyhet për një mbledhje tjetër dhe grupi punues të mbaj edhe një takim, të sqarohen ato që janë ngritur dhe sidomos vëmendja duhet kushtuar te rekomandimet sepse ato votohen në Kuvend.

Nëse ndonjëri prej anëtarëve të grupit punues e sheh që nevojshme të ndërhyjmë në ligj dhe të bëhet plotësim ndryshime duhet të saktësohet neni dhe ajo çka kërkohet për tu ndryshuar.

Latif Gashi theksoj se Draft Raporti është dorëzuar kurse dje kemi marrë disa komente dhe rekomandime nga znj. Bajrami, mirëpo nga asnjë anëtarë i Komisionit nuk kemi marrë asnjë plotësim ndryshim.

Pas diskutimeve, Kryetarja konstatoi se pika e tretë e rendit të ditës shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 20.11.2013

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje me amendamentet e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetaja theksoj se amendamentet e Komisionit Funkcional nuk kanë ndonjë kosto shtesë buxhetore. Opinioni i Ministrisë sponzorizuese dhe Departamentit të Buxhetit të MF, është se PL nuk ka kosto shtesë buxhetore dhe mund të zbatohet përmes mjeteve të parapara në Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe në buxhet.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Projektligjit Nr.04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe amendamentet e Komisionit Funkcional nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

4. Të ndryshme

Kryetarja theksoj se kemi një rekomandim nga Kryesia e Kuvendit që të shqyrtohet edhe një herë kërkesa e RTK-së për ndajren e mjeteve prej 1 milion euro sipas vendimit të Qeverisë. Qeveria ka marrë vendim që në kuadër të ndarjes të cilën ia lejon ligji për buxhetin t'ia ndaj RTK-së shumën prej 1 milion €. Tashmë është viti i tretë që RTK është nënprogram në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ismet Krasniqi sqaroi se të gjitha lëvizjet buxhetore për RTK-në në mënyrë permanente janë ndarë me rekomandim nga ana e Komisionit për Administratën për të bërë përcjelljen e transferit të mjeteve. Kanë qenë dy lëshime nga kjo procedurë, kur më 26 dhjetor 2012 Qeveria ka ndarë 550.000€, dhe më 31 dhjetor në emër të asaj se Kuvendi ka qenë në pauzë Kryetari ka nënshkruar për këtë shumë. Lëshimi i dytë ka qenë në rastin e ndarjes së 200.000€ me destinim të veçantë për blerjen e paisjeve për RTK-në. Të gjitha mjetet e tjera që kanë qenë për punën e RTK-së kanë kaluar përmes Komisionit dhe nga të gjitha takimet i është lëshuar rekomandim për administratën e Kuvendit për ndarje të mjeteve.

Më 18 nëntor kemi marrë njoftim nga Qeveria se Kuvendit të Kosovës i janë ndarë 1 milion € për RTK-në në kategorinë *Subvencione dhe Transfere*. Duke pas parasysh se të gjitha të ardhurat shkojnë në këtë kategori kemi marrë të arsyeshme që Komisioni të jep rekomandimin për alokimin e mjeteve duke mundësuar kryerjen e kësaj procedure. Dua të sqaroj një informacion teknik se unë si sekretar i Kuvendit nuk nënshkruaj asnjë dokument financiar pa vendim të Komisionit apo Kryesisë.

Latif Gashi vlerësoj se me këtë çështje është dashur të merreni kur është sjell vendimi nga Kryesia pasi që ne si Komision kemi përfunduar punën tonë. Na shqetëson fakti se vetëm për RTK-në politizohet dhe

kërkohet të vij përmes Komisionit për Buxhet dhe Financa. Jam pro që të bëhet rekomandimi për alokimin e mjeteve për RTK-në.

Albana Fetoshi theksoj se jam kundër ndarjes së mjeteve për RTK-në në këtë formë, pasi që nuk është dhënë ndonjë arsyetim për këto mjete. Mendoj se kjo shumë është si shpërblim për fushatën e kryeministrit që ka bërë. Ajo që është thënë herën e parë që është diskutuar që administrata ti respektojë procedurat ka qenë gabim për shkak se administrata nuk i respekton procedurat kur Kryeministri merren vendim për një qështje. Kur një qështje vjen në Kuvend, atëher Kuvendi duhet të merr vendim dhe votohet, atëherë administrata respekton procedurat. Është bërë një përpjekje që të bëhet kjo qështje e parëndësishme për komisionin, por kjo qështje është në kompetencë të komisionit pasi që jemi komision funksional dhe duhet të shqyrtojmë kërkesat. Mbështes përfundimin e Kryesisë që qështje të kalojë në seancë plenare dhe të diskutohet dhe vendoset atje.

Kryetarja theksoj se qështja e RTK është e ndishme por na ka sjell edhe tensione shumë por vet financimi i RTK ja nga buxheti nuk është diçka e mir sepse është televizion publik, mirëpo rrethanat tona e bëjnë këtë për me funksionue dhe zgjidhur kjo qështje. RTK –ja e dim se po përballet me vështërsi financiare dhe jemi dëshmitar të realitetit se me rishikimin e buxhetit kan bërë kërkesë në shumë prej 3 milion eurove. Mirëpo me rishikim të buxheti e kemi shikuar mirë kërkesën e RTK –së dhe me ministrinë finanacave e kemi refuzuar tërësisht sepse nuk kemi pas mjete për me lehtësu punën e funksionimit. Qeveria ka mundësuar RTK –së ato mjete që ka kërkuar për me funksionue, po unë them se nuk është pjesë e fushatës zgjedhore kjo, por ne ta analizojm profesionalisht këtë kërkesë dhe ta zgjedhim këtë problem.

Pas diksuktimeve dhe propozimeve, Komisionit me pesë vota Për (Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Sevdije Lama, një Kundër (Albana Fetoshi) dhe asnjë Abstenim, nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Administratës së Kuvendit të Kosovës të bëjë transferin e mjeteve financiare në vlerë prej 1,000.000 (një milion) euro në pajtim me procedurat për ndarjen e mjeteve nga buxheti i Kuvedit, kategoria ekonomike – subvencione dhe transfere në xhirollogarinë e Radio Televizionit të Kosovës, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.11/152, datë 18.10.2013.

Mbledhja përfundoi: 13:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj